



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**Kodi i lëndës: INF 530**  
**Lënda: Infermierore Bashkëkohore**

PROGRAMI I LËNDËS								
Teknikat Infermierore Bashkëkohore								
Titullari i lëndës:		Fatjona Kamberi <i>Lektore, PhD në Shkenca Infermierore</i> _____						
Ngarkesa:	ECTS	Orë mësimi në auditor					Studim individual	Totali
	10	Leksion	Seminar	Lab	Praktikë	Projekt klinik	125	
		45	0	15	65	0	250	
Tipologjia e lëndës		Disiplinë e formimit karakterizues të programit						
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri I						
Lloji i lëndës		E detyruar						
Programi i studimit		Master Shkencor në Shkenca Infermierore						
Kodi i lëndës		INF 530						
Adresa elektronike e titullarit / pedagogut të lëndës		<a href="mailto:fatjona.kamberi@univlora.edu.al">fatjona.kamberi@univlora.edu.al</a> <a href="mailto:fatjonakamberi@gmail.com">fatjonakamberi@gmail.com</a>						

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	Ky modul do të shërbejë studentëve për të njohur e praktikuar me teknikat më moderne shëndetësore të përditësuara, si dhe me procedurat infermierore më të avancuara bashkëkohore.
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none"><li>☞ Përfitimi i njohurive bazë dhe të avancuara në lidhje me teknikat infermierore bashkëkohore.</li><li>☞ Përditësimi i njohurive me të reja më të fundit për teknikat infermierore bazuar në evidenca shkencore nëpërmjet udhëzimeve hap pas hapi për kryerjen e procedurave infermierore më të zakonshme që infermierët duhet të njohin dhe të aplikojnë në praktikën klinike.</li><li>☞ Promovimi i komunikimit efektiv dhe konsistent në lidhje me sigurinë dhe cilësinë e kujdesit për pacientët.</li></ul>
Rezultatet e pritshme	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>☞ Njohin dhe të kryejnë në praktikën klinike teknikat infermierore bashkëkohore.</li><li>☞ Zbatojnë hap pas hapi në praktikë, procedurat infermierore, në funksion të përmirësimit të rezultateve të pacientit, reduktimit të gabimeve dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor të qëndrueshëm dhe me standarte.</li><li>☞ Marrin vendime klinike dhe të ndihmojnë në sigurimin e kujdesit cilësor edhe në situata shëndetësore jo shumë të njohura, si për infermierët studentë dhe ata klinikistë.</li></ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**KONCEPTET THEMELORE**

- Përditësimi i njohurive teorike dhe praktike në lidhje me teknikat bazë infermierore.
- Njohja dhe implementimi i teknikave infermierore bashkëkohore.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<p><b>Tema 1</b>– Njohja me programin dhe kërkesat e modulit. <i>Organizimi dhe fokusi i studimit të lëndës. Njohja me literaturën bazë dhe teknikat që do trajtohen në modul.</i></p> <p><b>Tema 2</b> – Higjena e duarve <i>Rëndësia e higjenës së duarve në parandalimin e infeksioneve, implementimi i teknikës dhe barrierat e hasura në praktikë për mosrealizimin gjithmonë të kësaj teknike infermierore.</i></p> <p><b>Tema 3</b> – Lirimi i rrugëve ajrore të obstruktura. <i>Teknika e liritimit të rrugëve ajrore të obstruktura për adultët koshient dhe jokoshient, për fëmijët, personat obezë dhe gratë shtatëzana.</i></p> <p><b>Praktikë 1-3.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermierore të trajtura në praktikën spitalore</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.5-6</p> <p><sup>(1)</sup>fq.7-10</p> <p><sup>(1)</sup>fq.11-14</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë Praktikë 4 orë</p>
II.	<p><b>Tema 4</b> – Reanimimi kardio-pulmonar. <i>Rëndësia e reanimimit kardio-pulmonar, rastet kur duhet të kryhet, implementimi i teknikës me një shpëtues dhe dy shpëtues. Kujdesi infermieror për të parandaluar komplikacionet e lidhura me teknikën jo korrekte.</i></p> <p><b>Tema 5</b> – Pranimi i pacientëve. <i>Hapat bazë që duhet të zbatohen nga infermieri për procedurë efektive të pranimit të pacientëve në spital.</i></p> <p><b>Tema 6</b> – Transferimi i pacientëve. <i>Përgatitja e duhur dhe dokumentimi që i nevojitet stafit infermieror për transferimin e pacientëve brenda faciliteteve spitalore.</i></p> <p><b>Praktikë 4-6.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermierore të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.15-24</p> <p><sup>(1)</sup>fq.25-27</p> <p><sup>(1)</sup>fq.28-29</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë Praktikë 4 orë</p>
III.	<p><b>Tema 7</b> – Dalja e pacientëve. <i>Njohja dhe zbatimi i elementëve bazë të procedurës së daljes së pacienteve nga spitali në funksion të planifikimit të kujdesit dhe vlerësim të vashduar të pacientëve për kujdes.</i></p> <p><b>Tema 8</b> – Mbledhja e sekrecioneve të hundës, grykës dhe sputumit. <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i teknikës për mbledhjen e sekrecioneve të hundës, grykës dhe sputumit. Komplikacionet, edukimi i pacientit dhe dokumentimi i teknikës.</i></p> <p><b>Tema 9</b> – Mbledhja e materialeve fekale. <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i teknikës. Edukimi i pacientit dhe dokumentimi i teknikës.</i></p> <p><b>Praktikë 7-9.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermierore të trajtura në</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.30-32</p> <p><sup>(1)</sup>fq.33-39</p> <p><sup>(1)</sup>fq.40-42</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.		Praktikë 4 orë
IV.	<p><b>Tema 10</b> – Kujdesi për kateterin. <i>Elementët bazë të implementimit të kujdesit për kateterin urinar. Edukimi i pacientit, komplikacionet e lidhura me teknikën dhe dokumentimi i procedurës.</i></p> <p><b>Tema 11</b> – Kateterizimi urinar: pacienti mashkull. <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i teknikës. Kujdesi infermior për parandalim të infeksioneve dhe komplikacioneve të lidhura me teknikën.</i></p> <p><b>Tema 12</b> – Kateterizimi urinar: pacienti femër. <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i teknikës. Kujdesi infermior për parandalim të infeksioneve dhe komplikacioneve të lidhura me teknikën.</i></p> <p><b>Praktikë 10-12.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiore të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre, komplikacionet e lidhura me teknikën.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.43-46</p> <p><sup>(1)</sup>fq.47-50</p> <p><sup>(1)</sup>fq.51-54</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë Praktikë 4 orë</p>
V.	<p><b>Tema 13</b> – Asepsia kirurgjikale: përgatitja dhe mbajtja e fushës sterile. <i>Teknika asepike dhe shembuj të teknikave asepike.</i></p> <p><b>Tema 14</b> – Heqja e dorezave të ndotura. <i>Teknika e heqjes së dorezave të ndotura, hapat dhe arsytet në para dhe post-procedurë.</i></p> <p><b>Tema 15</b> – Aplikimi i ngrohjes dhe ftohjes. <i>Indikacionet e aplikimit të ngrohjes dhe të ftohjes, materialet e nevojshme dhe hapat e implementimit të teknikës.</i></p> <p><b>Praktikë 13-15.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiore të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.55-58</p> <p><sup>(1)</sup>fq.58-60</p> <p><sup>(1)</sup>fq.61-64</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë Praktikë 4 orë</p>
VI.	<p><b>Tema 16</b> – Irigimi i kateterit të përhershëm urinar. <i>Indikacionet për irigimin e përhershëm të kateterit urinar, materialet e nevojshme, implementimi dhe dokumentimi i teknikës.</i></p> <p><b>Tema 17</b> – Irigimi i vazhdueshëm i fshikëzës. <i>Indikacionet për irigimin e vazhdueshëm të fshikëzës, materialet e nevojshme, implementimi dhe dokumentimi i teknikës.</i></p> <p><b>Tema 18</b> – Ndërrimi i qeskës së kolostomisë. <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i teknikës. Kujdesi infermior për parandalim të komplikacioneve të lidhura me teknikën, dokumentimi i procedurës dhe edukimi i pacientit.</i></p> <p><b>Praktikë 16-18.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiore të trajtura në praktikën spitalore, shpeshësia e përdorimit të këtyre teknikave në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.65-67</p> <p><sup>(1)</sup>fq.68-70</p> <p><sup>(1)</sup>fq.71-75</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë Praktikë 4 orë</p>
VII.	<p><b>Tema 19</b> – Administrimi i medikamenteve në rrugë orale. <i>Elementët bazë të administrimit të medikamenteve në rrugë orale, indikacionet, kujdesi infermior për reduktim të rreziqeve të lidhura me administrimin jo korrekt.</i></p> <p><b>Tema 20</b> – Administrimi i medikamenteve në rrugë sublinguale dhe bukale. <i>Elementët bazë të administrimit të medikamenteve në rrugë bukale dhe</i></p>	<p><sup>(1)</sup>fq.76-79</p> <p><sup>(1)</sup>fq.80-82</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
 FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
 DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>sublinguale, indikacionet dhe implementimi.</i></p> <p><b>Tema 21</b> – Përzjerja e medikamenteve në shiringë.  <i>Materialet e nevojshme, implementimi dhe kujdesi infermieror për të parandaluar komplikacione të lidhura me teknikën.</i></p> <p><b>Praktikë 19-21.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiere të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	( <sup>1</sup> )fq.83-86	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë          Praktikë 4 orë</p>
VIII.	<p><b>Tema 22</b> – Administrimi i injeksioneve intradermale.  <i>Materialet e nevojshme, implementimi, vendi i injektimit, kujdesi infermieror për parandalim të komplikacioneve të lidhura me teknikën, dokumentimi.</i></p> <p><b>Tema 23</b> – Administrimi i injeksioneve subkutane/Tërheqja e medikamentit nga ampula.  <i>Materialet e nevojshme, implementimi, vendi i injektimit, kujdesi infermieror për parandalim të komplikacioneve të lidhura me teknikën, dokumentimi.</i></p> <p><b>Tema 24</b> – Administrimi i injeksioneve intramuskulare.  <i>Materialet e nevojshme, implementimi, vendi i injektimit, kujdesi infermieror për parandalim të komplikacioneve të lidhura me teknikën, dokumentimi i teknikës.</i></p> <p><b>Praktikë 22-24.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiere të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p>(<sup>1</sup>)fq.87-90</p> <p>(<sup>1</sup>)fq.91-96</p> <p>(<sup>1</sup>)fq.97-102</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë          Praktikë 4 orë</p>
IX.	<p><b>Tema 25</b> – Administrimi i mjekimeve oftalmike.  <i>Materialet e nevojshme, implementimi, teknika e administrimit sipas tipit të medikamentit të përdorur.</i></p> <p><b>Tema 26</b> – Administrimi i medikamenteve në vesh.  <i>Materialet e nevojshme, implementimi, edukimi i pacientit, komplikacionet, dokumentimi.</i></p> <p><b>Tema 27</b> – Venipunktura.  <i>Materialet e nevojshme, hapat e implementimit të teknikës, kujdesi infermieror gjatë teknikës për parandalim të infeksioneve, zonat më të zakonshme për venipunkturë.</i></p> <p><b>Praktikë 25-27.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiere të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p>(<sup>1</sup>)fq.103-105</p> <p>(<sup>1</sup>)fq.106-108</p> <p>(<sup>1</sup>)fq.109-112</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë          Praktikë 4 orë</p>
X.	<p><b>Tema 28</b> – Përgatitja e një solucioni intravenë.  <i>Materialet e nevojshme dhe hapat e implementimit të teknikës.</i></p> <p><b>Tema 29</b> – Irgimi i plagës.  <i>Materialet e nevojshme, përgatitja e materialeve dhe hapat e implementimit të teknikës.</i></p> <p><b>Tema 30</b> – Marrja e kulturës nga plaga.  <i>Teknika dhe kujdesi infermieror gjatë teknikës.</i></p> <p><b>Praktikë 28-30.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiere të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p>(<sup>1</sup>)fq.113-116</p> <p>(<sup>1</sup>)fq.117-120</p> <p>(<sup>1</sup>)fq.121</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë          Praktikë 4 orë</p>
XI.	<p><b>Tema 31</b> – Administrimi i oksigjenit.  <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i teknikës në sistemet e ndryshme të</i></p>	( <sup>1</sup> )fq.122-129	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>administrimit të oksigjenit.</i></p> <p><b>Tema 32</b> – Aspirimi nazofaringeal dhe orofaringeal. <i>Materialet e nevojshme, implementimi i teknikës, komplikacionet dhe dokumentimi.</i></p> <p><b>Tema 33</b> – Kujdesi për trakeostominë. <i>Qëllimi i kujdesit të trakeostomisë, materialet e nevojshme, implementimi i teknikës, komplikacionet e lidhura me kujdesin dhe dokumentimi.</i></p> <p><b>Praktikë 31-33.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiere të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.130-133</p> <p><sup>(1)</sup>fq.134-140</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë Praktikë 4 orë</p>
XII.	<p><b>Tema 34</b> – Aspirimi i trakeostomisë. <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i teknikës.</i></p> <p><b>Tema 35</b> – Ushtrimet instruktive pasive-ROM. <i>Indikacionet dhe benefitet e kryerjes së ushtrimeve ROM. Implementimi i lëvizjeve në artikulacione të ndryshme.</i></p> <p><b>Tema 36</b> – Vendosja e tubit nazogastrik/ nazointestinal për aspirim dhe ushqyerje enterale. <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i vendosjes së tubave.</i></p> <p><b>Praktikë 34-36.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiere të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.134-140</p> <p><sup>(1)</sup>fq.141-147</p> <p><sup>(1)</sup>fq.148-149</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë Praktikë 4 orë</p>
XIII.	<p><b>Tema 37</b> – Administrimi i tubave ushqyes enteralë. <i>Vendosja dhe heqja e tubave ushqyes enteralë nëpërmjet hundës dhe gojës, edukimi i pacientit, komplikacionet dhe dokumentimi i teknikës.</i></p> <p><b>Tema 38</b> – Injeksionet IV me bolus. <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i teknikës. Komplikacionet e lidhura me teknikë jo korrekte dhe dokumentimi.</i></p> <p><b>Tema 39</b> – Ndërrimi i plagëve kirurgjikale. <i>Materialet e nevojshme dhe implementimi i teknikës së ndërrimit të plagëve kirurgjikaleë, kujdesi infermior.</i></p> <p><b>Praktikë 37-39.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiere të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.149-151</p> <p><sup>(1)</sup>fq.152-155</p> <p><sup>(1)</sup>fq.156-159</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë Praktikë 4 orë</p>
XIV.	<p><b>Tema 40</b> – Monitorimi i pacientëve me dëmtim të gëlltitjes dhe rrezik për aspirim. <i>Menaxhimi i pacientëve me vështirësi në gëlltitje.</i></p> <p><b>Tema 41</b> – Monitorimi post-operator i pacientëve. <i>Materialet e nevojshme, implementimi dhe komplikacionet e mundshme të lidhura me kujdesin infermior.</i></p> <p><b>Tema 42</b> – Vendosja në izolim parandalues strikt. <i>Indikacionet, kujdesi infermior dhe implementimi i teknikës.</i></p> <p><b>Praktikë 40-42.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermiere të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.160-164</p> <p><sup>(1)</sup>fq.165-168</p> <p><sup>(1)</sup>fq.169-171.</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Laborator 1 orë Praktikë 4 orë</p>
XV.	<p><b>Tema 43</b> – Menaxhimi i dhimbjes.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.172-176</p>	<p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
 FAKULTETI I SHËNETIT PUBLIK  
 DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Njohja me teknikat kryesore të vlerësimit dhe menaxhimit të dhimbjes.</i></p> <p><b>Tema 44</b>– Kujdesi për kateterin intravenoz.  <i>Elementët bazë të kujdesit për kateterin intravenoz, komplikacionet e lidhura me kujdesin dhe dokumentimi i procedurës.</i></p> <p><b>Tema 45</b> – Mekanika trupore.  <i>Njohja me parimet kryesore të mekanikës trupore, implementimi.</i></p> <p><b>Praktikë 43-45.</b> Përdorimi dhe zbatimi i teknikave infermierore të trajtura në praktikën spitalore, barrierat e hasura në mos zbatimin korrekt të tyre.</p>	<p><sup>(1)</sup>fq.177-181</p> <p><sup>(1)</sup>fq.182-184</p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Laborator 1 orë</i>  <i>Praktikë 4 orë</i></p>

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

FREKUENTIMI:						
		<p>Kyçi i një edukimi të suksesshëm është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>				
KONTROLLI I VAZHDUESHËM	Forma e vlerësimit	Koha e vlerësimit	Temat mësimore që do vlerësohen	Pikët maksimale	Forma e testimit të njohurive	Përmbajtja e testimit
	Provimi final	Fundi i semestrit	45 leksionet	85 pikë	Provimi me shkrim	Pyetje me shtjellim, pyetje quiz, përshkrimi dhe implementimi i teknikave infermierore hap pas hapi
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Studim klinik	15 pikë	Prezantim me gojë	Përdorimi në praktikë i teknikave infermierore bashkëkohore spitalore. Ndarja studentëve në grupe për hartimin e 4 projekteve klinike me fokus njohjen dhe implementimin në praktikë të teknikave të ndryshme infermierore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<i>*Vlerësim i vazhduar - Do të jetë në formën e një projekti që do të fillojë në fillim të semestrit. Studentët do të zhvillojnë një studim në lidhje me përdorimin e teknikave infermiere bashkëkohore në praktikën klinike. Është parashikuar prezantimi i studimeve në formatin ppt.</i>					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
5	6	7	8	9	10	

LITERATURA	
<b>Literatura bazë e detyruar</b>	(1) Teknikat Infermiere. Kamberi Fatjona . Cikël leksionesh, botimi i parë 2017. Shtypur në Vlorë, Triptik botime. ISBN:978-9928-245-10-6.
<b>Literatura e rekomanduar</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>◦ Nursing Procedures' Lippincott Williams &amp; Wilkins seventh edition 2016 . ISBN - 978-1-4698-5303-1.</li><li>◦ Clinical Nursing Skills and Techniques / Edition 7 Anne Griffin Perry, Patricia A. Potter, 2009. ISBN-13: 9780323052894, ISBN: 0323052894.</li><li>◦ Advanced Practice Nursing: An Integrative Approach / Edition 4. Ann B. Hamric, Judith A. Spross, Charlene M. Hanson. 2008. ISBN-13: 9781416043928, ISBN: 1416043926</li><li>◦ Understanding Nursing Research: Building an Evidence-Based Practice / Edition 5, Nancy Burns, Susan K. Grove, 2010, ISBN-13: 9781437707502, ISBN: 1437707505</li></ul>

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p>fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penaltete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.</p>
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	<p>Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.</p>
<b>Karakteristikat e detyrave të kursit</b>	<p><i>Rregullat për paraqitjen e detyrave / projekteve të kursit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Të gjitha punimet duhet të dorëzohen në kohën e caktuar. Ato duhet të tregojnë që në paraqitje një stil profesionist.</li><li>▪ Duhet të jenë të shtypura. Punet me shkrim dore nuk do të pranohen dhe studenti do të vlerësohet automatikisht me 0 pikë.</li><li>▪ Në punime gjuha duhet të jetë zyrtare, letrare dhe neutrale. Ndalohet rreptësisht përdorimet e zhargoneve të pa argumentuara, shprehjet që rëndojnë etikën profesionale dhe njerëzore, kërcënimet, fyerjet, sharjet, etiketimet, tendencat politizuese, trajtimet jashtë tematikave të kërkuara, etj.</li><li>▪ Punët duhet të kenë një volum me më tepër se 3 faqe (format A<sup>4</sup>, shkrimi Times New Roman, 12 pt) dhe në faqet e para duhet të jenë të shënuara pa gabime drejtshkrimore:</li></ul> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin: 10px 0;"><p>Emri i Studentit Titulli i punimit Kursi dhe grupi përkates i studentit Data e dorëzimit të punimit sipas grafikut të shpallur Emri i instruktorit Numri i faqeve</p></div> <p><i>Elementët e vlerësimit të detyrës së kursit do të përfshijnë:</i></p> <p>Thelbësore:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Respektimin e struktureve të punimit shkencor</li><li>▪ Renditjen e argumenteve akademiko-shkencorë</li><li>▪ Mënyrat specifike të trajtimit të çështjeve në raport me realitetin shqiptar</li></ul> <p>Ndihmëse:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Ideja e zgjedhur</li><li>▪ Mënyra e organizimit të punimit</li><li>▪ Logjika e përdorimit të koncepteve</li><li>▪ Përputhja me objektivat e programit mësimor</li><li>▪ Argumentet dhe analiza kritike</li></ul>